VENDIM
Nr. 640, datë 7.9.2016

PËR KALIMIN E SPORTELEVE TË SHËRBIMIT TË FONDIT TË SIGURIMIT TË DETYRUESHËM TË KUJDESIT SHËNDETËSOR NË ADMINISTRIM TË AGJENCISË SË OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2 e 3, të nenit 50, të ligjit nr. 13/2016, "Për mënyrën e ofrimit në sportel të shërbimeve publike në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin e sporteleve të shërbimit të Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) në administrim të Agjencisë së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), në bashkitë Kavajë e Fier.

2. Për një periudhë kohe deri në konsolidimin e mënyrës së ofrimit të shërbimeve, ky shërbim do të ofrohet, njëkohësisht, nga ADISA dhe FSDKSH-ja.

3. Ngarkohen Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama